

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-46/11

Prishtinë
14 qershor 2011

Në procedurën e

Z.A.

Paraqitësi i kërkesës/Ankuesi

Kolegji i Apelit të AKP-ës i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Antoinette Lepeltier-Durel, kryetare e kolegjit, Anne Kerber dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/84/2010, (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA 51242), të datës 2 shtator 2010, pas shqyrtimit të mbajtur me 14 qershor 2011, morri këtë

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e Z.A..
- 2- Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore i Kosovës, KPCC/D/A/84/2010, për sa i përket lëndës së regjistruar me numrin KPA 51242, të datës 30 prill 2008
- 3- Obligohet ankuesi që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 55 (pesëdhjetë) euro, brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Historiku procedural dhe faktik:

Me 13 nëntor 2007, paraqitësi i kërkesës Z.A. ia ka paraqitur kërkesën e tij pronësore Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) në lidhje me një pronë që ndodhet në Rahovec, zona kadastrale e Gexhë, ngastra kadastrale nr. 82, tokë e klasës së tretë me sipërfaqe prej 1024 m². Kërkesa është regjistruar si KPA51242.

Paraqitësi i kërkesës ka potencuar se ai ka qenë posedues i kësaj prone, dhe se e kishte humbur pronën si rezultat i rrethanave të viteve 98/99 në Kosovë. Ai nuk e ka ditur se çfarë kishte ndodhur me pronën e tij. Për më tepër, ai ka thënë se nuk është zhvilluar ndonjë procedurë trashëgimore. Ai ka kërkuar ri-posedimin e pronës.

Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës ia ka paraqitur AKP-së dokumentet e mëposhtme:

- fletën poseduese nr. 39, të lëshuar me 16 tetor 2007, nga Zyra Kadastrale për Prona të Paluajtshme në Rahovec, ku ceket se ngastra nr. 82 kishte qenë në posedim të J.A.;
- një dokument të nënshkruar nga J.A., “*e veja e të ndjerit I. A.*” me 28 korrik 1970, me anë të së cilit autorizohet thjeshtri i saj “*A.I.Z.*” lidhur me pronën e regjistruar në fletën poseduese nr. 44 të komunës kadastrale të Rahovecit, Gegjë. Dokumenti është vërtetuar nga Gjykata Komunale në Titograd.

Fleta poseduese dhe autorizimi kanë mundur të verifikohen nga zyrtarët e AKP-së. Pasi që fleta posedues tregonte se J.A. ishte pronarja e jo paraqitësja e kërkesës, zyrtarët e AKP-së e kanë kontaktuar paraqitësin e kërkesës dhe kanë kërkuar sqarim nga ai. Paraqitësi i kërkesës i ka informuar ata se J.A. ishte njerka e tij dhe se kishte vdekur. Më vonë, ai ka njoftuar AKP-në se J.A. nuk kishte pasur ndonjë fëmijë dhe se paraqitësi i kërkesës ishte fëmija i vetëm i babait të tij, prandaj askush nuk ka mundur ta konfirmojë lidhjen familjare.

Kur është kërkuar që ta dëshmojë lidhje familjare, paraqitësi i kërkesës ia ka paraqitur AKP-së një certifikatë të vdekjes që supozohet të jetë e njerkes së tij (bartësit të së drejtës pronësore). Certifikata e vdekjes ka treguar se “J.B.”, e lindur me 22 mars 1922 dhe qytetare e Republikës së Malit të Zi kishte vdekur me 31 dhjetor 2006 në Gorican, Mal të Zi, dhe se emri i bashkëshortit të saj ishte I. B..

Ky dokument nuk ka mundur të verifikohet. Në pyetjen e AKP-së, paraqitësi i kërkesës ka sqaruar se I.B. kishte qenë bashkëshorti i parë i njerksës së tij.

Me 5 dhe 29 maj 2009, paraqitësit të kërkesës i është kërkuar që ta paraqes certifikatën e martesës brenda një afati prej 30 ditësh. Paraqitësi i kërkesës është pajtuar por nuk e ka bërë këtë.

Me 10 korrik 2009, paraqitësit të kërkesës i është kërkuar që ta paraqes certifikatën e tij të lindjes brenda një afati prej 30 ditësh. Paraqitësi i kërkesës është pajtuar por nuk e ka bërë këtë..

Me 18 gusht 2010, paraqitësit të kërkesës i është kërkuar që ta paraqes certifikatën e vdekjes së babait të tij (pasi që certifikata e tij e lindjes dhe certifikatat e martesës së njerksës së tij tashmë veç i ishin kërkuar) dhe me këtë të vërtetojë se bartja e të drejtave të pretenduara pronësore i përkiste njerksës së tij. Paraqitësi i kërkesës ka thënë se nuk kishte qenë në posedimi të këtij dokumenti.

Me 2 shtator 2010, KKPK-ja e ka hedhur poshtë këtë kërkesë në mungesë të dëshmisë së kapacitetit të paraqitësit të kërkesës për të parashtruar kërkesë në emër të bartësit të së drejtës pronësore dhe në mungesë të dëshmisë se paraqitësi i kërkesës është pronar i saj (KPCC/D/A/84/2010).

Vendimi i është dorëzuar ankuesit me 25 shkurt 2011.

Me 28 mars 2011, paraqitësi i kërkesës (më tutje në tekst: ankuesi) ka parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme. Ai ka thënë se ai ishte trashëgimtar i “J. A.-B.”, pasi që babai i tij i ndjerë Ilija kishte qenë i martuar me të. Veç kësaj, ai kishte autorizimin lidhur me tërë pronën e paluajtshme i cili i jep atij të drejtë të pakufizuar për zgjidhjen e çështjes së pronës. Në mbështetje të ankesë së tij, ankuesi paraqiti në gjykatë jo vetëm fletën poseduese 39, autorizimin e vitit 1970 dhe certifikatën e vdekjes së J.B., por edhe fletën poseduese nr. 243 të Zyrës Kadastrale në Rahovec (mbase që ka të bëjë me kërkesat tjera të ankuesit) dhe certifikatën e tij të martesës të lëshuar me 25 maj 2009 nga Republika e Serbisë, “*qyteti i Kryshevcit, Rahovec*” ku ceket se me 23 qershor 1955 ai ishte martuar në Bela Crkva dhe emri i nënë së tij kishte qenë J.B..

Ankuesi kishte kërkuar anulimin e vendimit kundërshtuar the kthimin e lëndës për rigjykim apo pranimin e kërkesës si të bazuar dhe ndryshimin e vendimit.

Arsyetimi ligjor:

1. Ankesa është e pranueshme. Ajo është parashtruar brenda periudhës 30 ditore të paraparë me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079. Sipas nenit 7.1, pika (a) të Urdhëresës Administrative. 2007/5 të ndryshuar me Ligjin. 03/L-79, kur periudha kohore shprehet me ditë, javë apo muaj duhet “ *të llogaritet nga çasti në të cilin ndodh veprimi, dita gjatë së cilës ka ndodhur ngjarja apo veprimi nuk do të llogaritet se i takon periudhës në fjalë*”. Prandaj kjo periudhë duhet të llogaritet nga 23 shkurti 2011, kur është dorëzuar dokumenti. Kjo periudhë do të duhej të mbaronte me 27 mars 2011. Pasi që ka qenë e diele, sipas nenit 7.2 të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të ndryshuar me Ligjin 03/L-79, kjo periudhë ka përfunduar në ditën e parë vijuese të punës, kjo datë është 28 marsi 2011, në ditën kur ankesa është dorëzuar.

2. Megjithatë, ankesa është e bazuar.
 - a) Ankuesi thekson se ai është pronar i pronës së kontestuar pasi që e kishte trashëguar atë. Megjithatë, ai nuk ka paraqitur ndonjë provë se është trashëgimtar i J.A.. Ai nuk i ka zhvilluar procedurat e duhura trashëgimore, kështu që nuk është në gjendje të dorëzojë ndonjë dokument në mbështetje të asaj se ai është trashëgimtari i saj. Pasi që nuk është në fushëveprim të juridiksionit të gjykatës për të vendosur për çështjet trashëgimore, gjykata nuk do të vendos nëse ankuesi është trashëgimtar J.A.. Megjithatë, gjykata dëshiron të shtojë se sipas neneve 11 deri në 16 të Ligjit nr. 2004/26 (Ligjit për Trashëgiminë në Kosovë) thjeshtri nuk është trashëgimtar sipas ligjit. Autorizimi i dorëzuar as nuk dëshmon se ankuesi është trashëgimtar e as nuk dëshmon se ankuesi është pronar i ngastrave të pretenduara. Kjo rrjedh nga fakti se autorizimi nuk ka të bëjë me pronësi apo trashëgimi, në këtë rast autorizimi madje as nuk ka të bëjë me ngastrën e pretenduar.

 - b) Pasi që autorizimi nuk ka të bëjë me ngastrën e pretenduar ai nuk mund t'i jap të drejtë ankuesit të kërkojë ngastrën (madje edhe vetëm) në emër të njerëks së tij.

 - c) Po ashtu, KKKPK-ja tashmë ka potencuar se ankuesi ka paraqitur prova që vërtetojnë të drejtën e tij për të parashtruar kërkesë në emër të njerëks së tij si anëtar i bashkësisë familjare. Neni 5.2 i Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2007/5 të ndryshuar me Ligjin 03/L-79 thekson: “*Në procedurën para Komisionit, kur një person fizik nuk ka mundësi të paraqes kërkesë, kërkesa mund të bëhet nga një anëtar i bashkësisë familjare së atij personi*”. Sipas nenit 1 të

rregullores së lartpërmendur, “anëtarë i bashkësisë familjare” do të thotë: *“bashkëshorti/ja, fëmijët (të lindur brenda apo jashtë kurorës apo të adaptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t’i mbështes në përputhje me ligjin në fuqi, apo personat të cilët janë të obliguar ta mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në përputhje me ligjin në fuqi”*.

Ankuesi ka paraqitur certifikatën e vdekjes së njerkes së tij dhe, së bashku me ankesën e tij, edhe certifikatën e tij të martesës, të lëshuar 25 maj 2009 nga Republika e Serbisë, *“gyteti i Kryshevit, Rabovev”*. Ai nuk ka ofruar sqarim se përse nuk i kishte paraqitur dokumentin e tij gjatë procedurës së kërkesë para KKPK-së, i cili ka vendosur me 2 shtator 2010, që është në shumë së një vit me vonë. Prandaj, gjykata nuk e pranon këtë provë dhe nuk e shqyrton atë (neni 12.11 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 *“Faktet e reja dhe dëshmitë materiale të paraqitura nga cilado palë lidhur me ankesën nuk pranohen dhe nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme përpos nëse tregohet se faktet dhe dëshmitë e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palën në fjalë”*). Por edhe nëse gjykata do ta shqyrtonte atë, duke përmendur vetëm emrin e nënës së tij J.B., i cili madje nuk është as i njëjtë me emrin e së ndjerës J.B., kjo nuk vërteton se ankuesi ishte adaptuar nga njerka e tij apo nëse ekzistonte ndonjë obligim për njerken e tij që ta mbështeste atë apo anasjelltas. Po ashtu, certifikata e vdekjes së njerkes së tij nuk vërteton ndonjë lidhje familjare ndërmjet ankuesit dhe njerkes së tij. .

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me nenin 8.4 të Shtojcës III, të Urdhërësës Administrative (UD) 2007/5 e ndryshuar nga Ligji nr: 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës që zhvillohet para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit.

Megjithatë një përjashtim i tillë nuk parashihet edhe për procedurën para Gjykatës Supreme. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Shpenzimet Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UD Nr:2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Shpenzimeve Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Ankesave. .

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Tarifa e taksës gjyqësore për paraqitjen e ankesës (Neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €

- Tarifa e taksës gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (Nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë mund të vlerësohet me arsyeshmërisht midis € 2500 deri € 5000: €25.

Këto tarifa gjyqësore do të bartën nga ankuesi i cili e humb rastin. Në përputhje me nenin 46 paragrafi 1 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e tarifave nga një person me vendbanim apo vendqëndrim jashtë vendit nuk mund të jetë me pak 30 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendosi që në rastin aktual, tarifat gjyqësore duhet të paguhen nga ankuesi brenda 90 ditëve nga dita që atij i është dorëzuar aktgjykimi.

Këshillë juridike

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Nënshkruar nga: Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Nënshkruar nga: Anne Kerber, Gjyqtare e EULEX-it

Nënshkruar nga: Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Nënshkruar nga: Urs Nufer, Referent i EULEX-it